



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:198804  
Datë: 24.04.2024  
Numri i dokumentit: 05615466

C.nr.638/19

**GJYKATA THEMELORE MITROVICA**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren individuale Erolinda Uka-Sadiku, në çështjen juridiko - kontestimore të paditësit I., A., H., A.,V., A., M., A., M., A., V., K.,-A., M., H., -A., A., B.,-A., dhe B., F., që të gjithë nga ., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Dijar Jusufi avokat në Mitrovicë, kundër të paditurve G., A., Fsh. Zh., i E., K-, dhe G., G., me vendbanim në rrugën “.” në ., me bazë kontesti: Anulim Kontrate dhe Vërtetim Pronësie mbi bazën e trashëgimisë pas mbajtjes se seancës se shqyrtimit kryesor me dt. 20.04.2024 nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve I., A., H., A.,V., A., M., A., M., A., V., K.,-A., M., H., -A., A., B.,-A., dhe B., F., të gjithë nga ., si e bazuar.

**a)VËRTETOHET** se është nule kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë në parcelën kadastrale 00200-0 ZK-, LRP. Nr. i Referencës 185/1837/2013, e dt. 30.04.2013, e lidhur në mes të paditurit të parë G., A., nga ., dhe të paditurit të dytë G., G., nga ., për ngastrën kadastrale 00200-0, në sipërfaqe prej 445 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur .,

**b)VËRTETOHET** se paditësi I., A., si pasardhës i tani të ndjerit A., A., ish nga ., është bashkëpronar në bazë të trashëgimisë me nga 1/10 pjesë të ngastrës kadastrale me numër 00200-0 me kulturë arë e klasës së 1 me sipërfaqe prej 445m<sup>2</sup> në vendin e quajtur “.-Z.K .,-Komuna ., me masa dhe kufij duke filluar nga Veriu nga pika 18 deri në pikën 19 me gjatësi prej 12.88m, nga pika 19-20 me gjatësi 3.97 m, nga pika 20-21 me gjatësi prej 3.61m, nga pika 21-22 me gjatësi prej 5.22 m, nga pika22-23 me gjatësi prej 6.56 m, nga pika 23-24 me gjatësi prej 2.54 m, nga pika 24-25 me gjatësi prej 14.19 m, nga pika 25-26 me gjatësi prej 6.04m, nga pika 26-27 me gjatësi prej 6.27 m, në pjesën lindore nga pika 27-11 me gjatësi 5.3 m, nga pika 11-12 me gjatësi prej 7.55 m, ndërsa në pjesën jugore nga pika 12-13 me gjatësi prej 8.6 m, nga pika 13-14 me gjatësi prej 7.03m, nga pika 14-15 me gjatësi prej 17.08 m, ndërsa në pjesën perëndimore nga pika 15-16 me gjatësi 7.23 m, nga pika 16-17 me gjatësi 4.29 m, nga pika 17-18 me gjatësi prej 2.52 m dhe nga pika 18-19 me gjatësi prej 12.88m,

c) Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njëjti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrin kadastral si bashkëpronar të ngastrës së cekur si në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**II. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve I., A., H., A., V., A., M., A., M., A., V., K., -A., M., H., -A., A., B., -A., dhe B., F., të gjithë nga „si e bazuar.

**a) VËRTETOHET** se është nule kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë në parcelën kadastrale 00200-0 ZK-., LRP. Nr. i Referencës 185/1837/2013, e dt. 30.04.2013, e lidhur në mes të paditurit të parë G., A., nga „, dhe të paditurit të dytë G., G., nga „, për ngastrën kadastrale 00200-0, në sipërfaqe prej 445 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur „,

**b) VËRTETOHET** se paditësi H., A., si pasardhës i tani të ndjerit A., A., ish nga „, është bashkëpronar në bazë të trashëgimisë me nga 1/10 pjesë të ngastrës kadastrale me numër 00200-0 me kulturë arë e klasës së 1 me sipërfaqe prej 445m<sup>2</sup> në vendin e quajtur „.-Z.K., i „.-Komuna „, me masa dhe kufij duke filluar nga Veriu nga pika 18 deri në pikën 19 me gjatësi prej 12.88m, nga pika 19-20 me gjatësi 3.97 m, nga pika 20-21 me gjatësi prej 3.61m, nga pika 21-22 me gjatësi prej 5.22 m, nga pika 22-23 me gjatësi prej 6.56 m, nga pika 23-24 me gjatësi prej 2.54 m, nga pika 24-25 me gjatësi prej 14.19 m, nga pika 25-26 me gjatësi prej 6.04m, nga pika 26-27 me gjatësi prej 6.27 m, në pjesën lindore nga pika 27-11 me gjatësi 5.3 m, nga pika 11-12 me gjatësi prej 7.55 m, ndërsa në pjesën jugore nga pika 12-13 me gjatësi prej 8.6 m, nga pika 13-14 me gjatësi prej 7.03m, nga pika 14-15 me gjatësi prej 17.08 m, ndërsa në pjesën perëndimore nga pika 15-16 me gjatësi 7.23 m, nga pika 16-17 me gjatësi 4.29 m, nga pika 17-18 me gjatësi prej 2.52 m dhe nga pika 18-19 me gjatësi prej 12.88m,

c) Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njëjti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrin kadastral si bashkëpronar të ngastrës së cekur si në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**III. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve I., A., H., A., V., A., M., A., M., A., V., K., -A., M., H., -A., A., B., -A., dhe B., F., të gjithë nga „, si e bazuar.

**a) VËRTETOHET** se është nule kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë në parcelën kadastrale 00200-0 ZK-., LRP. Nr. i Referencës 185/1837/2013, e dt. 30.04.2013, e lidhur në mes të paditurit të parë G., A., nga „, dhe të paditurit të dytë G., G., nga „, për ngastrën kadastrale 00200-0, në sipërfaqe prej 445 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur „,

**b) VËRTETOHET** se paditësi V., A., si pasardhës i tani të ndjerit A., A., ish nga „, është bashkëpronar në bazë të trashëgimisë me nga 1/10 pjesë të ngastrës kadastrale me numër 00200-0 me kulturë arë e klasës së 1 me sipërfaqe prej 445m<sup>2</sup> në vendin e quajtur „S.-Z.K „, i „.-Komuna „, me masa dhe kufij duke filluar nga Veriu nga pika 18 deri në pikën 19 me gjatësi prej 12.88m, nga pika 19-20 me gjatësi 3.97 m, nga pika 20-21 me gjatësi prej 3.61m, nga pika 21-22 me gjatësi prej 5.22 m, nga pika 22-23 me gjatësi prej 6.56 m, nga pika 23-24 me gjatësi prej 2.54 m, nga pika 24-25 me gjatësi prej 14.19 m, nga pika 25-26 me gjatësi prej 6.04m, nga pika 26-27 me gjatësi prej 6.27 m, në pjesën lindore nga pika 27-11 me gjatësi 5.3 m, nga pika 11-12 me gjatësi prej 7.55 m, ndërsa në pjesën jugore nga pika 12-13 me gjatësi prej 8.6 m, nga pika

13-14 me gjatësi prej 7.03m, nga pika 14-15 me gjatësi prej 17.08 m, ndërsa në pjesën perëndimore nga pika 15-16 me gjatësi 7.23 m, nga pika 16-17 me gjatësi 4.29 m, nga pika 17-18 me gjatësi prej 2.52 m dhe nga pika 18-19 me gjatësi prej 12.88m,

c) Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njëjti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrinkadastral si bashkëpronar të ngastrës së cekur si në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**IV.APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve I., A., H., A., V., A., M., A., M., A., V., K., -A., M., H., -A., A., B., -A., dhe B., F., të gjithë nga ., si e bazuar.

**a)VËRTETOHET** se është nule kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë në parcelën katastrale 00200-0 ZK-., LRP. Nr. i Referencës 185/1837/2013, e dt. 30.04.2013, e lidhur në mes të paditurit të parë G., A., nga ., dhe të paditurit të dytë G., G., nga ., për ngastrën kadastrale 00200-0, në sipërfaqe prej 445 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur .,

**b)VËRTETOHET** se paditësi M., A., si pasardhës i tani të ndjerit A., A., ish nga ., është bashkëpronar në bazë të trashëgimisë me nga 1/10 pjesë të ngastrës kadastrale me numër 00200-0 me kulturë arë e klasës së 1 me sipërfaqe prej 445m<sup>2</sup> në vendin e quajtur “.”-Z.K ., i ., Komuna ., me masa dhe kufij duke filluar nga Veriu nga pika 18 deri në pikën 19 me gjatësi prej 12.88m, nga pika 19-20 me gjatësi 3.97 m, nga pika 20-21 me gjatësi prej 3.61m, nga pika 21-22 me gjatësi prej 5.22 m, nga pika 22-23 me gjatësi prej 6.56 m, nga pika 23-24 me gjatësi prej 2.54 m, nga pika 24-25 me gjatësi prej 14.19 m, nga pika 25-26 me gjatësi prej 6.04m, nga pika 26-27 me gjatësi prej 6.27 m, në pjesën lindore nga pika 27-11 me gjatësi 5.3 m, nga pika 11-12 me gjatësi prej 7.55 m, ndërsa në pjesën jugore nga pika 12-13 me gjatësi prej 8.6 m, nga pika 13-14 me gjatësi prej 7.03m, nga pika 14-15 me gjatësi prej 17.08 m, ndërsa në pjesën perëndimore nga pika 15-16 me gjatësi 7.23 m, nga pika 16-17 me gjatësi 4.29 m, nga pika 17-18 me gjatësi prej 2.52 m dhe nga pika 18-19 me gjatësi prej 12.88m,

c) Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njëjti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrinkadastral si bashkëpronar të ngastrës së cekur si në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**V.APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve I., A., H., A., V., A., M., A., M., A., V., K., -A., M., H., -A., A., B., -A., dhe B., F., të gjithë nga ., si e bazuar.

**a)VËRTETOHET** se është nule kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë në parcelën katastrale 00200-0 ZK-., LRP. Nr. i Referencës 185/1837/2013, e dt. 30.04.2013, e lidhur në mes të paditurit të parë G., A., nga ., dhe të paditurit të dytë G., G., nga ., për ngastrën kadastrale 00200-0, në sipërfaqe prej 445 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur .,

**b)VËRTETOHET** se paditësi M., A., si pasardhës i tani të ndjerit A., A., ish nga ., është bashkëpronar në bazë të trashëgimisë me nga 1/10 pjesë të ngastrës kadastrale me numër 00200-0 me kulturë arë e klasës së 1 me sipërfaqe prej 445m<sup>2</sup> në vendin e quajtur “.”-Z.K ., -Komuna ., me masa dhe kufij duke filluar nga Veriu nga pika 18 deri në pikën 19 me gjatësi prej 12.88m, nga pika 19-20 me gjatësi 3.97 m, nga pika 20-21 me gjatësi prej 3.61m, nga pika 21-22 me gjatësi prej 5.22 m, nga pika 22-23 me gjatësi prej 6.56 m, nga pika 23-24 me gjatësi prej 2.54

m, nga pika 24-25 me gjatësi prej 14.19 m, nga pika 25-26 me gjatësi prej 6.04m, nga pika 26-27 me gjatësi prej 6.27 m, në pjesën lindore nga pika 27-11 me gjatësi 5.3 m, nga pika 11-12 me gjatësi prej 7.55 m, ndërsa në pjesën jugore nga pika 12-13 me gjatësi prej 8.6 m, nga pika 13-14 me gjatësi prej 7.03m, nga pika 14-15 me gjatësi prej 17.08 m, ndërsa në pjesën perëndimore nga pika 15-16 me gjatësi 7.23 m, nga pika 16-17 me gjatësi 4.29 m, nga pika 17-18 me gjatësi prej 2.52 m dhe nga pika 18-19 me gjatësi prej 12.88m,

c)Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njëjti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrin kadastral si bashkëpronar të ngastrës së cekur si në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**VI.APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve I., A., H., A.,V., A., M., A., M., A., V., K.,-A., M., H., -A., A., B.,-A., dhe B., F., të gjithë nga ., si e bazuar.

**a)VËRTETOHET** se është nule kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë në parcelën kadastrale 00200-0 ZK-Mitrovicë,LRP. Nr. i Referencës 185/1837/2013, e dt. 30.04.2013, e lidhur në mes të paditurit të parë G., A., nga ., dhe të paditurit të dytë G., G., nga ., për ngastrën kadastrale 00200-0, në sipërfaqe prej 445 m2, në vendin e quajtur .,

**b)VËRTETOHET** se paditësi V., K.,-A., si pasardhëse e tani të ndjerit A., A., ish nga Mitrovica, është bashkëpronar në bazë të trashëgimisë me nga 1/10 pjesë të ngastrës kadastrale me numër 00200-0 me kulturë arë e klasës së 1 me sipërfaqe prej 445m2 në vendin e quajtur “.”-Z.K Zhabar i Epërm-Komuna ., me masa dhe kufij duke filluar nga Veriu nga pika 18 deri në pikën 19 me gjatësi prej 12.88m, nga pika 19-20 me gjatësi 3.97 m, nga pika 20-21 me gjatësi prej 3.61m, nga pika 21-22 me gjatësi prej 5.22 m, nga pika22-23 me gjatësi prej 6.56 m, nga pika 23-24 me gjatësi prej 2.54 m, nga pika 24-25 me gjatësi prej 14.19 m, nga pika 25-26 me gjatësi prej 6.04m, nga pika 26-27 me gjatësi prej 6.27 m, në pjesën lindore nga pika 27-11 me gjatësi 5.3 m, nga pika 11-12 me gjatësi prej 7.55 m, ndërsa në pjesën jugore nga pika 12-13 me gjatësi prej 8.6 m, nga pika 13-14 me gjatësi prej 7.03m, nga pika 14-15 me gjatësi prej 17.08 m, ndërsa në pjesën perëndimore nga pika 15-16 me gjatësi 7.23 m, nga pika 16-17 me gjatësi 4.29 m, nga pika 17-18 me gjatësi prej 2.52 m dhe nga pika 18-19 me gjatësi prej 12.88m,

c)Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njëjti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrin kadastral si bashkëpronar të ngastrës së cekur si në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**VII. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve I., A., H., A.,V., A., M., A., M., A., V., K.,-A., M., H., -A., A., B.,-A., dhe B., F., të gjithë nga ., si e bazuar.

**a)VËRTETOHET** se është nule kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë në parcelën kadastrale 00200-0 ZK-.,LRP. Nr. i Referencës 185/1837/2013, e dt. 30.04.2013, e lidhur në mes të paditurit të parë G., A., nga ., dhe të paditurit të dytë G., G., nga ., për ngastrën kadastrale 00200-0, në sipërfaqe prej 445 m2, në vendin e quajtur .,

**b)VËRTETOHET** se paditësja M., H.,-A., si pasardhëse e tani të ndjerit A., A., ish nga ., është bashkëpronar në bazë të trashëgimisë me nga 1/10 pjesë të ngastrës kadastrale me numër 00200-0 me kulturë arë e klasës së 1 me sipërfaqe prej 445m2 në vendin e quajtur “.”-Z.K .,-Komuna

., me masa dhe kufij duke filluar nga Veriu nga pika 18 deri në pikën 19 me gjatësi prej 12.88m, nga pika 19-20 me gjatësi 3.97 m, nga pika 20-21 me gjatësi prej 3.61m, nga pika 21-22 me gjatësi prej 5.22 m, nga pika22-23 me gjatësi prej 6.56 m, nga pika 23-24 me gjatësi prej 2.54 m, nga pika 24-25 me gjatësi prej 14.19 m, nga pika 25-26 me gjatësi prej 6.04m, nga pika 26-27 me gjatësi prej 6.27 m, në pjesën lindore nga pika 27-11 me gjatësi 5.3 m, nga pika 11-12 me gjatësi prej 7.55 m, ndërsa në pjesën jugore nga pika 12-13 me gjatësi prej 8.6 m, nga pika 13-14 me gjatësi prej 7.03m, nga pika 14-15 me gjatësi prej 17.08 m, ndërsa në pjesën perëndimore nga pika 15-16 me gjatësi 7.23 m, nga pika 16-17 me gjatësi 4.29 m, nga pika 17-18 me gjatësi prej 2.52 m dhe nga pika 18-19 me gjatësi prej 12.88m,

c).Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njeiti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrin kadastral si bashkëpronar të ngastrës së cekur si në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**VIII. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve I., A., H., A.,V., A., M., A., M., A., V., K.,-A., M., H., -A., A., B.,-A., dhe B., F., të gjithë nga ., si e bazuar.

**a)VËRTETOHET** se është nule kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë në parcelën katastrale 00200-0 ZK-.,LRP. Nr. i Referencës 185/1837/2013, e dt. 30.04.2013, e lidhur në mes të paditurit të parë G., A., nga ., dhe të paditurit të dytë G., G., nga ., për ngastrën kadastrale 00200-0, në sipërfaqe prej 445 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur ..

**b)VËRTETOHET** se paditësja A., B.,-A., si pasardhëse e tani të ndjerit A., A., ish nga ., është bashkëpronare në bazë të trashëgimisë me nga 1/10 pjesë të ngastrës kadastrale me numër 00200-0 me kulturë arë e klasës së 1 me sipërfaqe prej 445m<sup>2</sup> në vendin e quajtur “Selishte/Lugi”-Z.K .,-Komuna ., me masa dhe kufij duke filluar nga Veriu nga pika 18 deri në pikën 19 me gjatësi prej 12.88m, nga pika 19-20 me gjatësi 3.97 m, nga pika 20-21 me gjatësi prej 3.61m, nga pika 21-22 me gjatësi prej 5.22 m, nga pika22-23 me gjatësi prej 6.56 m, nga pika 23-24 me gjatësi prej 2.54 m, nga pika 24-25 me gjatësi prej 14.19 m, nga pika 25-26 me gjatësi prej 6.04m, nga pika 26-27 me gjatësi prej 6.27 m, në pjesën lindore nga pika 27-11 me gjatësi 5.3 m, nga pika 11-12 me gjatësi prej 7.55 m, ndërsa në pjesën jugore nga pika 12-13 me gjatësi prej 8.6 m, nga pika 13-14 me gjatësi prej 7.03m, nga pika 14-15 me gjatësi prej 17.08 m, ndërsa në pjesën perëndimore nga pika 15-16 me gjatësi 7.23 m, nga pika 16-17 me gjatësi 4.29 m, nga pika 17-18 me gjatësi prej 2.52 m dhe nga pika 18-19 me gjatësi prej 12.88m,

c).Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njëjti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrin kadastral si bashkëpronare të ngastrës së cekur si në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**IX. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve I., A., H., A.,V., A., M., A., M., A., V., K.,-A., M., H., -A., A., B.,-A., dhe B., F., të gjithë nga ., si e bazuar.

**a)VËRTETOHET** se është nule kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë në parcelën katastrale 00200-0 ZK-Mitrovicë,.,LRP. Nr. i Referencës 185/1837/2013, e dt. 30.04.2013, e lidhur në mes të paditurit të parë G., A., nga ., dhe të paditurit të dytë G., G., nga ., për ngastrën kadastrale 00200-0, në sipërfaqe prej 445 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur ..

**b)VËRTETOHET** se paditësja B., F., si pasardhëse e tani të ndjerit A., A., ish nga ., është bashkëpronare në bazë të trashëgimisë me nga 1/10 pjesë të ngastrës kadastrale me numër 00200-0 me kulturë arë e klasës së 1 me sipërfaqe prej 445m2 në vendin e quajtur “.”-Z.K ., i .,-Komuna ., me masa dhe kufij duke filluar nga Veriu nga pika 18 deri në pikën 19 me gjatësi prej 12.88m, nga pika 19-20 me gjatësi 3.97 m, nga pika 20-21 me gjatësi prej 3.61m, nga pika 21-22 me gjatësi prej 5.22 m, nga pika22-23 me gjatësi prej 6.56 m, nga pika 23-24 me gjatësi prej 2.54 m, nga pika 24-25 me gjatësi prej 14.19 m, nga pika 25-26 me gjatësi prej 6.04m, nga pika 26-27 me gjatësi prej 6.27 m, në pjesën lindore nga pika 27-11 me gjatësi 5.3 m, nga pika 11-12 me gjatësi prej 7.55 m, ndërsa në pjesën jugore nga pika 12-13 me gjatësi prej 8.6 m, nga pika 13-14 me gjatësi prej 7.03m, nga pika 14-15 me gjatësi prej 17.08 m, ndërsa në pjesën perëndimore nga pika 15-16 me gjatësi 7.23 m, nga pika 16-17 me gjatësi 4.29 m, nga pika 17-18 me gjatësi prej 2.52 m dhe nga pika 18-19 me gjatësi prej 12.88m,

c)Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njëjti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrin kadastral si bashkëpronare të ngastrës së cekur si në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**X.OBLIGOHET** i padituri i parë G., A., nga ., që paditësve në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ua kompensoj shumën e përgjithshme prej 1,167.6 € brenda afatit 15 ditor nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësit I., A., H., A.,V., A., M., A., M., A., V., K.,-A., M., H., -A., A., B.,-A., dhe B., F., që të gjithë nga Fsh. ., Komuna e ., me padinë e parashtruar kundër të paditurve G., A., dhe G., G., në gjykatë me datë 09.07.2013, kanë kërkuar nga gjykata Anulimin e kontratës së shitblerjes e paluajtshmerisë LRP.nr. 185/1837/2013, e dt. 30.04.2013të lidhur në mes të paditurit të parë dhe të dytë, para noteri ., nga ., ashtu që detyrohen të paditurit ., e ., të ua njohin të drejtën e pronësisë në parcelën kontestuese dhe të njëjtit t’i lejojnë ta regjistrojnë në emrin e tyre, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

### **Rrjedha e procedurës**

Gjykata Themelore në Mitrovicë, e aktgjykimin C.nr.476/13 të datës 02.12.2014, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, ka anuluar kontratën e lidhur mes të paditurit të parë dhe të dytë, ka vërtetuar se paditësit janë bashkëpronarë me nga 1/11 në parcelën P-71208032-00200-., në vendin e quajtur ., në sipërfaqe prej 445 m2, ka obliguar të paditurit që t’ia lejojnë paditësve regjistrimin e të drejtës së tyre në regjistrat përkatës kadastral si dhe ka obliguar të paditurit që në mënyrë solidare të paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë totale prej 669 euro brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjykata e Apelit, pasi kishte shqyrtuar ankesën e të paditurit të dytë me Aktvendimin Ac.nr.773/15 të datë 27.06.2019, kishte aprovuar si të themeltë ankesën e të paditurit të dytë G., G., ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr.476/13 të datës 02.12.2014 e kishte prishur dhe çështjen e kishte kthyer në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata në rigjykim, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësve dhe i paditurit i dytë, ndërsa për të paditurin e parë nuk ka prezantuar askush, edhe pse është ftuar me rregull, por që mungesën nuk e ka arsyetuar.

Gjykata me propozimin e paditësit e në bazë të nenit 423 par 4 të LPK-së, ka mbajtur e shqyrtimit kryesor pa praninë e të paditurës së parë.

### **Pretendimet e palëve ndërgjyqëse**

Gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare të paditësit përmes të autorizuarit të tyre deklaruan se mbesin pranë padisë dhe kërkesëpadisë të parashtruar në këtë gjykatë dhe precizimeve në seancat e mëhershme duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovojë në tërësi si të bazuar pasi që nga provat e administruara vërtetohet se i padituri i parë G., A., në mënyrë të kundërligjshme i ka përjashtuar nga trashëgimia trashëgimtarët e tjerë vëllezërit dhe motrat e tij e që në këtë rast si rezultat i kësaj ndaj të njëjtit ishte iniciuar procedura penale dhe i njëjti për këtë është dënuar me aktgjykim të formës së prerë është shpallur fajtor dhe është dënuar, në dispozitivin ku është anuluar edhe aktvendimi me të cilin i padituri i parë është shpallur trashëgimtari i vetëm andaj me vet faktin që ky aktvendim është anuluar të gjitha veprimet e tjera pas nxjerrjes së këtij janë nule dhe duhet anuluar e në këtë rast propozoj që edhe kontrata për shitblerje të anulohet pasi që kjo kontratë është në kundërshtim me dispozitat ligjore mbi trashëgiminë dhe LMD-në, propozoj që trashëgimtarët të shpallen bashkëpronarë me 1/10 në këtë parcelë kadastrale.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë për 3 seanca gjyqësore shumen prej 405.60€(135X3=405) si dhe në emër të padisë shumën prej 312€ dhe 375 € në emër të ekspertizës gjeodete si dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 100.

I padituri i dytë në fjalën përfundimtare deklaroi se unë kontratën për shitblerje e kam lidhur në mënyrë ligjore, pagesën e kam bërë me transaksion bankar, paluajtshmërinë e kam blerë dhe nuk e di ku po mbesë me të, as nuk më kanë kërkuar që të takohemi që të bëjmë ndonjë zgjidhje, janë munduar të më njollosin edhe me fajde.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

### **Provat e administruara**

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: Aktvendimin për Trashëgimin me numër T.nr.101/12 i datës 11.09.2012; Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me numër Ref.185/1837/2013 e datës 30.04.2013, e lidhur në mes të paditurit të parë G., A., dhe të paditurit të dytë G., G., Certifikatat e lindjes për paditësit I., A., H., A., V., A., M., A., M., A., V., K., -A., M., H., -A., A., B., -A., dhe B., F.; Certifikata e pronësisë e datës 09.11.2012; Procesverbali i daljes në vend i datës 23.10.2023; Aktgjykim i Gjykatës së Apelit të Kosovës me nr. PAKR.nr.149/2017 i datës 20.04.2017; Ekstrakti i lindjes

për Z., B., Ekstraktet e lindjes për B., F., M., H., V., K., dhe A., B., Deklarata e z.Zyrafete Bajraktari e datës 16.01.2023 me të cilën ka hequr dorë nga të gjitha drejtat që i takojnë nga trashëgimia në bazë të ligjit dhe nga ndjekja e çështjes në gjykatë; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.61/2015 të datës 08.03.2017, certifikatën e pronësisë numër UL-71208032-00058 e lëshuar me datën 09.10.2012, certifikatën e pronësisë me nr. 15-942-03-0079152 e lëshuar me datën 27.10.2013, ekspertizën e gjeodezisë të përpiluar nga eksperti gjeodet .,

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, konform dispozitës së nenit 8, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për këto arsye:

### **Faktet jo kontestuese**

Nuk është kontestuese se paditësit I., A., H., A.,V., A., M., A., M., A., V., K.,-A., M., H., -A., A., B.,-A., dhe B., F.,janë bijtë dhe bijat e tani të ndjerit A., A., ky fakt vërtetohet në bazë të ekstrakteve të lindjes së paditësve.

Faktin se i padituri i parë G., A., është shpall trashëgimtar i vetëm ligjor i të ndjerit A., A., kjo gjykatë e vërtetoi nga aktvendimi mbi trashëgimin Tr.Nr.101/2012 i datës: 11.09.2012, kopja e të cilit gjendet në shkresat e lëndës.

I padituri i parë pasi është shpall trashëgimtar i vetëm ligjor në tërë pasurinë e të ndjerit Agush Ahmeti, u ka shitur personave të tretë të gjitha pronat, ndër to edhe paluajtshmërinë lëndore me numër parcele P-00200-0, në vendin e quajtur “.” në sipërfaqe prej 445 m2, ia ka shitur tani të paditurit të dytë G., G., fakt i vërtetuar nga Kontrata për Shitblerje LRP. Nr. i Referencës 185/1837/2013, e dt. 30.04.2013, paracela kadastrale P-7208032-00200-, lloj i pronës parcelë, Zona Rural, Adresa e njësisë Selishte-Lugi, lloj i shfrytëzimit të parcelës bujqësore , shfrytëzimi aktual i parcelës kullojë në sipërfaqe prej 445 m2.

Sipas pikës së tretë të Kontratës për Shitblerje LRP. Nr. i Referencës 185/1837/2013, e dt. 30.04.2013, rezulton se çmimi i shitblerjes së paluajtshmërisë është në shumë prej 26.000.00 euro.

I pa kontestueshëm mbetet fakti që i padituri i parë është shpallur fajtorë për mashtrim dhe për deklaram te Rrem me aktgjykimin penal P.nr.61/2015 te dt. 08.03.2017 dhe është dënuar sipas ligjit, i cili vendim është i vërtetuar edhe me aktgjykimin e shkalles së dytë PAKR.nr.149/2017 te dt. 20.04.2017.

Sipas ekspertizës së ekspertit gjeodet prona kontestuese e cila evidentohet sipas certifikatës së pronësisë në Zonën Kadastrale ., evidentohet në emër të këtu paditurit të dytë Gani Gëxhalija në të 1/1 është e regjistruar parcela kadastrale me nr. 00200-0 me kulturë arë e klasës së 1 me sipërfaqe 445m2, në vendin e quajtur “Selishte”, e cila parcelë kadastrale në anën veriore kufizohet me parcelën kadastrale me nr.00202-4, në anën lindore kufizohet me parcelën



kadastrale me nr.00256-0, në anën jugore kufizohet me parcelën kadastrale me nr.00201-3, dhe në anën perëndimore kufizohet me parcelat kadastrale me nr. 00201-0 dhe 00201-2.

Tutje në ekspertizë është treguar historiat e pronësisë së parcelës kontestuese nga e cila vërtetohet se në bazë të dokumentacionit nga Drejtoria e Gjeodezisë, Kadaster, Pronë, parcela kadastrale me nr. P-200-0, me kulturë-kullosë klasa 1 me sipërfaqe prej 445 m<sup>2</sup>, 199-11 me sipërfaqe prej 425 m<sup>2</sup>, 199-12 me sipërfaqe prej 674 m<sup>2</sup> sipas regjistrimit të ndërrimit 10/2012 nga A., A., me 1/1 e pjesës së pronës në bazë të Aktvendimit mbi Trashëgiminë 101/12 e datës 11.09.2012 GJKM kanë kaluar në emër të G., A.,.

Parcela kadastrale 200-0 në sipërfaqe prej 445 m<sup>2</sup> sipas regjistrimit të ndërrimit 15/2013 në bazë të kontratës së shitblerjes LRP.nr.ref.185/1837/2013 e dt.13.04.2013 nga G., A., ka kaluar në emër të G., G.,

### **Faktet Kontestuese:**

Në mes të palëve ndërgjyqëse ishte kontestuese e drejta e pronësisë për parcelën 00200-0, e cila evidentohet në emër të të paditurit të dytë G., G.,

Paditësit të drejtën e vet e mbështesin në faktin se në parcelën kontestuese janë bashkëpronar në bazë të trashëgimisë, së bashku me të paditurin e parë G., A., dhe kërkojnë që të anulohet kontrata mbi shitblerje të paluajtshmërisë dhe të shpallen bashkëpronarë në parcelën 00200-0 me nga 1/10.

### **Baza juridike**

Në këtë çështje juridike kontestimore do të zbatohen dispozitat ligjore të parapara me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, numër. 04/L-077 të vitit 2012, tani e tutje LMD, për shkak se marrëdhënia detyrimore është krijuar me datën 30.04.2013, me lidhjen e kontratës për shitblerjen e paluajtshmërisë kontestuese në mes të paditurit të parë si shitës dhe të paditurit të dytë si blerës.

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) në nenin 39 par.4 ka përcaktuar se “*Secili detyrim kontraktues duhet të ketë bazën e lejueshme. 2. Baza është e palejueshme në rast se është në kundërshtim me dispozitat e rendit publik, dispozitat tjera urdhëruese dhe moralin e shoqërisë, ndërsa në paragrafin tre të këtij neni është përcaktuar se “Në rast se nuk ka bazë ose baza është e palejueshme, kontrata është nul dhe absolutisht e pavlefshme”.*

Tutje në nenin 89 par.1 të LMD-së është përcaktuar “1. *Kontrata që është në kundërshtim me rendin publik, dispozitat urdhëruese, ose moralin e shoqërisë është nule, në qoftë se qëllimi i rregullës së cenuar nuk udhëzon në ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diç tjetër”.*

Gjykata, nga provat e cekura më lartë dhe nga gjendje faktike të vërtetuara, e duke u bazuar në dispozitat ligjore, konkretisht në nenin 95 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili përcakton se “*Për nulitetin gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe në atë mund të thirret çdo person i interesuar*”

Neni 96 i ligjit të lartcekur parasheh se “*E drejta e paraqitjes së kërkesës për kërkimin e nulitetit nuk shuhet.*”

Mbështetur në atë se baza me anë të secilës i padituri i parë ka fituar pronësinë gjegjësisht që është shpallur trashëgimtar i vetëm ligjor i tani të ndjerit A., A., është anuluar me vendim në procedurë penale, atëherë edhe veprimet gjegjësisht vendimet e mëvonshme ex-lege duhet anuluar sepse konsiderohet se pala nuk ka pas të drejtë të disponojë me atë pasuri në drejtim të se cilës është e drejtuar kërkesa.

I padituri i dytë sipas nenit 94 të LMD-së ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit nga i padituri i parë për anulimin e kësaj kontrate nëse vërteton se nuk ka qenë në dijeni për ekzistimin e këtyre rrethanave, i cili nën përcakton “*Kontraktuesi që është fajtor për lidhjen e kontratës nule i përgjigjet bashkë kontraktuesit të tij për dëmin që pëson për shkak të nulitetit të kontratës, në qoftë se ky nuk ishte në dijeni apo sipas rrethanave nuk do të duhej të ishte në dijeni për ekzistimin e shkakut të nulitetit*”

Kjo gjykatë në këtë çështje kontestimore është bindur dhe vlerëson se personat e tretë gjegjësisht i padituri i dytë) ka mundur të mos jetë në dijeni se i padituri i parë nuk ka pasur të drejtë të disponojë me atë pasuri, pasi që kundërligjshëm është shpallur trashëgimtar.

Andaj në rastin konkret, duke u bazuar në faktin se Aktvendimi CT.nr.101/12, i datës 11.09.2012 është anuluar me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.61/15 të datës 08.03.2017 dhe është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.nr.149/17 të datës 20.04.2017, gjykata vërtetoi se Kontrata mbi shitblerjen është nule për faktin se është në kundërshtim me dispozitat urdhërore, në rastin konkret dispozitat e ligjit të trashëgimisë, andaj mbi këtë bazë gjykata vendosi si në pikën a) të dispozitivit I,II,III,IV,V,VI,VII,VIII,IX, të aktgjykimit.

Gjykata vlerësoj se vendosja e kësaj çështje juridike kontestuese si në pikën b) të dispozitivit të I,II,III,IV,V,VI,VII,VIII,IX të këtij aktgjykimi sa i përket fitimit të pronësisë me 1/10 në bazë të trashëgimisë gjen mbështetje ligjore në dispozita të Ligjit për Trashëgimi i Kosovës, (LTK) dhe atë:

Me dispozitat e nenit 3 par. 1 të LTK-së i cili flet për Barazinë në trashëgimi, parashihet “ të gjithë personat fizikë në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi”.

Po ashtu me dispozitat e nenit 4 par. 1 dhe 2 të LTK-së, i cili flet për fitimin e trashëgimisë parashihet se trashëgimia “*Trashëgohet për shkak të vdekjes dhe në momentin e vdekjes së personit fizik*”, kurse par. 2 parasheh se “*Mund të trashëgohet secili person fizik*”.

Sipas dispozitës së nenit 5 par. 2 të LTK-ës, parashihet se “*Secili person është i aftë për të trashëguar, po që se me ligj nuk është paraparë ndryshe*”.

Neni 7 par.1 i LTK-ës, përcakton se zotësinë për te trashëguar ka *“Personi që në kohën e hapjes së trashëgimisë është gjallë, ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë, ka zotësi për të trashëguar”*.

Sipas dispozitave nga neni 11 i LTK-së, përcaktohen trashëgimtarët ligjorë ku parashihet se si *“Trashëgimtarë ligjorë janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre”*

Neni 30 i LTK-së flet për trashëgimtarët e domosdoshëm ne përgjithësi, ku thotë *“Trashëgimtarë të domosdoshëm janë: pasardhësit e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, prindërit dhe bashkëshorti i tij”*

Neni 139 par.1 i LTK-së i cili flet për ndarjen e trashëgimisë parasheh *“Ndarjen e trashëgimit mund ta kërkojë çdo trashëgimtar në çdo kohë, por jo në një kohë të papërshtatshme”*, ndërsa par. 2 i pot e njëjtë nen parasheh se *“Kjo e drejtë nuk parashkruhet”*.

Duke ju referuar dispozitave të cituar më lartë gjykata vlerësoj së në rastin konkret duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi që paditësit janë përjashtuar nga trashëgimia në kundërshtim me dispozitat e lartcekura, pasi qe të njëjtë si pasardhës të tani te ndjerit Agush Ahmeti, janë trashëgimtar të radhës së parë se bashku me të paditurin e parë.

Si trashëgimtare ligjore e rendit te parë të tani të ndjerit A., A., është edhe Z., B., e vajzërisë A., e njëjta ka dhënë deklaratë me shkrim, dhe ka deklaruar se heqë dorë nga trashëgimia që i takon sipas ligjit, e po ashtu ka deklaruar se nuk dëshiron qe të jetë pjesë në çështjen juridike civile, andaj mbi këtë rrethanë e njëjta nuk ka qenë palë në këtë procedurë.

Me aktvendimin mbi trashëgiminë paditësit janë privuar nga e drejta në trashëgimi pasi sipas Ligjit për Trashëgimin nenit 12 të këtij ligji në radhën e parë të trashëgimisë hyjnë bashkëshorti dhe pasardhësit e trashëgimlënësit. Pasardhësit e trashëgimlënësit që konsiderohen fëmijët e trashëgimlënësit trashëgojnë në pjesë të barabarta.

Në rastin konkret trashëgimtar i vetëm është shpallur vetëm i padituri i parë dhe me këtë është shkelur kjo normë ligjore imperative.

Ligji për Trashëgimin me nenin 138 paragrafi 1 dhe 2 përcakton se e drejta e trashëgimtarit për të kërkuar pjesën e vetë të trashëgimisë ndaj poseduesit me mirëbesim parashkruhet brenda afatit 10 vjeçar ndërsa ndaj poseduesit me keqbesim parashkruhet brenda afatit 20 vjeçar.

Nga kontrata mbi shitblerjen e lidhur në mes të paditurit të parë dhe të dytë në zyrën noteriale, vërtetohet se i padituri i parë ia ka shitur të paditurit të dytë paluajtshmërinë lëndore me numër parcele P-200-0, në vendin e quajtur “.” në sipërfaqe prej 445 m2.

Me aktgjykimin P.nr.61/2015 të datës 08.02.2017 dhe të vërtetuar në pjesën në të cilën ka pasoja në këtë lëndë nga aktgjykimi me nr. PAKR.nr149/2017 i datës 20.04.2017 i Gjykatës së Apelit, këtu i padituri i parë G., A., është dënuar me aktgjykim të formës së prerë për veprën penale të Mashtrimit, dhe me të njëjtin aktgjykim është anuluar aktvendimi për trashëgimin me numër T.nr.101/2012 i datës 11.09.2012. Dhe sipas nenit 14 të LPK-së “*Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor*”

### **Vlerësimet përfundimtare të gjykatës**

Gjykata vjen në përfundim se në këtë çështje juridike kontestimore, paditësit kanë arritur të vërtetojnë faktin se paraardhësi i tyre A., A., ka qenë pronarë i parcelës kontestuese numër 0200-0, kjo vërtetohet nga historiat i pronës i bashkangjitur ekspertizës gjeodezike.

Tutje paditësit kanë provuar faktin se i padituri i parë G., A., me Aktvendimin mbi Trashëgiminë 101/12 e datës 11.09.2012, është shpallur trashëgimtar i vetëm ligjor i trashëgimlënësit A., A., dhe pronësinë mbi paluajtshmërinë kontestuese e ka fituar në mënyrë të kundërligjshme përmes mashtrimit dhe deklaramit të rremë e kjo vërtetohet në bazë të Aktgjykimit Penal P.nr.61/2015 te dt. 08.03.2017 dhe është dënuar sipas ligjit, i cili vendim është i vërtetuar edhe me aktgjykimin e shkallës së dytë PAKR.nr.149/2017 te dt. 20.04.2017.

Tutje paditësit kanë vërtetuar faktin se i padituri i parë pasi është shpallur trashëgimtarë i vetëm ligjor, me datën 30.04.2013 ka lidhur kontratën mbi shitblerjen me të paditurin e dytë G., G.,

Në këtë çështje juridike kontestimore kemi te bëjmë me bashkëpronësi, pasi që sipas nenit 51 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore parashihet se *ne qoftë se pronësia në një send u takon disa personave në pjesë të caktuara ata kanë bashkëpronësi ne send*, ndërsa neni 52 paragrafi 3 parashihet që *bashkëpronari mund të disponoj me pjesën e tij ne send pa pëlqimin e bashkëpronarëve të tjerë*, mirëpo ne rastin konkret i padituri i parë ka mundur të disponoj me pjesën e tij por jo edhe me pjesën e bashkëpronarëve të tjerë. Po ashtu neni 53 i këtij Ligji parashihet që *punët e administrimit të rregullt të bashkëpronësisë janë të pa vlefshme pa pëlqimin e bashkëpronarëve, pjesët e të cilëve së bashku përbëjnë më shumë se 50%*.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të paditurit të dytë se i njëjti ka lidhur kontratën në përputhje me ligjin se ka paguar çmimin për blerjen e paluajtshmësisë, mirëpo siç kemi cekur edhe më lartë në këtë procedurë është vërtetuar fakti se bartja e të drejtës së pronësisë tek i padituri i parë është bërë në mënyrë të kundërligjshme përmes veprave penale të mashtrimit dhe deklaramit të rremë, e që nënkupton faktin se bashkëpronarët nuk kanë qenë në dijeni për këto veprime të paligjshme të paditurit të parë, përkundër faktit se i padituri i dytë jetë me mirëbesim kjo nuk do të thotë që bashkëpronarët e ligjshëm të mos kenë të drejtën e tyre për mbrojtjen etë drejtave që ndërlidhen me pasurinë e tyre.

Kjo e drejtë ligjore paditësve i garantohet edhe me dispozitën e neneve 1, 2, 6, 8 në lidhje me nenin 18 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore pasi që e drejta e pronësisë është e

drejt subjektive e karakterit absolut dhe si e tillë gëzon mbrojtje ne te gjitha sistemet. Ndërsa neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh se “*E drejta e pronës është e garantuar, shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik, askush nuk do të privohet nga prona në mënyrë arbitrare, Republika e Kosovës ose Autoriteti Publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve eksproprijohet*” në lidhje me protokollin I te Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Lirive të Njeriu.

Mbi bazën e vërtetuar te gjendjes faktike si me lart gjykata vendosi qe kërkesëpadinë e paditësve ta miratoi në tërësi si te bazuar e duke e marr parasysh edhe interesat e paditësve e që duhet te mbrohen.

Në lidhje me shpenzimet procedurale të paditësve, gjykata vendosi që këto shpenzime ti barë i padituri i parë Gadaf Ahmeti nga Mitrovica, konform nenit 449 e në lidhje me nenin 452 te LPK-së.

Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses për 3 seanca të mbajtura, nga 135 €, e në total për tri seanca shumë prej 405 €, për ekspertizë të gjeodezisë shumë prej 350 €, për përpilimin e padisë shumë prej 312€, shumë për pagesën e taksës gjyqësore prej 100 ne total shumë prej 1,167.6 €.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në dispozitat e nenit 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.638/19 Datë: 20.04.2024**

**G j y q t a r j a**

---

Erolinda Uka-Sadiku

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Ndaj këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës brenda afatit 15 ditor që nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:198804  
Datë: 24.04.2024  
Numri i dokumentit: 05615466